

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	ver. 1.2	faqe 1 nga 4
Departamenti i Burimeve Njerëzore		Sektori i Personelit

Bazuar në nenin 8 dhe nenin 10 (paragrafi 2.1) të Ligjit të punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenin 4 (paragrafi 1, 2, 3, 4, 5) dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe pikën 4.4, 5.1.2, 6.2 dhe 9.2 të Politikës së Rekrutimit, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh. a. shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitave të punës në kohë të caktuar:

1. 1 (një) Inxhinier/e për zhvillim të rrjetit dhe dizajn
2. 1 (një) Inxhinier/e për testim, mirëmbajtje dhe akordim të releve

Kushtet e përgjithshme:

Kohëzgjatja e punësimit: Për kohë të caktuar si zëvendësim i përkohshëm i punëtorëve për dy pozitat e Inxhinierëve si më lart gjatë periudhës të lejuar të pushimit pa pagesë nga punëdhënësi KOSTT e deri në kthimin e tyre në vendet e punës, pas përfundimit të studimeve master jashtë vendit si përfitues të bursës.

Kohëzgjatja e punësimit për pozitën nën nr.1 1 (një) Inxhinier/e për zhvillim të rrjetit dhe dizajn në kohë të caktuar për periudhën prej një (1) viti nga data 16.10.2023 deri me datën 15.10.2024.

Kohëzgjatja e punësimit për pozitën nën nr.2 1 (një) Inxhinier/e për testim, mirëmbajtje dhe akordim të releve në kohë të caktuar për periudhën prej 15 muaj nga data 01.10.2023 deri me datën 03.01.2025.

Në tekstin në vijim përdorimi i njëres gjini nuk përjashton gjininë tjetër.

Orari i punës: Puna me orar të plotë. Lartësia e pagës do të përcaktohet në harmoni me politikat e aprovuara të KOSTT-it.

Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën : Inxhinier/e për zhvillim të rrjetit dhe dizajn

Nr. referues i pozitës: 1.11.1.1

Detyrat e përgjithshme

Inxhinieri për zhvillimin e rrjetit dhe dizajn mbështet Menaxherin për Zhvillimin e Rrjetit në sigurimin e operimin afatgjatë të linjave dhe nënstacioneve dhe në përgatitjen e vendimeve lidhur me nevojën për infrastrukturë të re në transmision.

Detyrat specifike:

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të tij janë:

Zhvillimi i Rrjetit

- Ndihmon që vazhdimisht të marrë informata për të mundësuar performancën afatgjatë të sistemit.
- Ndihma në mbledhjen të dhënave dhe nevojshme për zhvillimin ose vlerësimin e planeve afatgjata të gjenerimit dhe transmisionit.
- Mbështet në para vlerëson ndryshimet e gjenerimit dhe tregut për të përgatitur vendimet për zhvillimin e rrjetit.
- Ndihma në vlerësimin e përshtatshmërisë së sistemit.

- Ndihma në vlerësimin e planit e zhvillimit të transmisionit, dhe studimet tjera për rrjetin.
- Mbështet planifikimin e investimeve në parashikimin afatgjatë dhe planifikimin e ekspansionit të transmisionit.
- Kryen programet e mirëmbajtjes, inspektimit, dhe zëvendësimit të linjave dhe nënstacioneve.
- Krijimi i dizajneve të specifikacioneve në pajtim me rregullat e kompanisë dhe specifikat e menaxhimit të aseteve.
- Definon dizajnin elementar të pajisjeve që duhet të implementohen.
- Planifikimi i investimeve në rrjetin e transmisionit në aspektin teknik dhe përgatitjen e Termeve të Referencës (TeR) për projektet investive.
- Mbikëqyrë aplikacionet dhe marrëveshjet për kyçe dhe proceson të gjitha dokumentet në përputhje me Metodologjinë e Taksave të Kyçjes.
- Përgatitja e Studimit të Fizibilitetit për projektet investive.

Menaxhimi i Aseteve

- Ndihmon në zhvillimin e menaxhimit të ciklit të jetës së aseteve.
- Ndihmon në vlerësimin e menaxhimit të rrezikut dhe shfrytëzimit.
- Përgatit caqet për kualitetin e furnizimit.
- Implementon politikën e mirëmbajtjes përfshirë edhe programet e mirëmbajtjes dhe inspektimit, programet e zëvendësimit.
- Përcjellë dhe vlerëson programet e realizimit.
- Përgatit udhëzimet për standardizimin e ndërtimeve dhe pajisjeve.

Të tjera

Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri i Zhvillimit të Rrjetit dhe të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT.

Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera të Inxhinierit për zhvillim të rrjetit dhe dizajn:

Kandidatët/et përveç kushteve të përgjithshme të punësimit të cilat kërkohen me ligj, duhet ti plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike niveli Bachelor
- Njohuri elementare të industrisë së shërbimeve publike
- Përvojë pune profesionale 1 vit
- Përvojë në zhvillimin e rrjetit
- Njohja e gjuhës angleze

Kushtet e punës: Puna në zyre dhe teren

Vendi/Lokacioni: Selia Qendrore e KOSTT-it

Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën: Inxhinier/e për testim, mirëmbajtje dhe akordim të releve Nr. referues i pozitës: 1.6.5.1

Detyrat e përgjithshme

Inxhinieri i Mbrojtjes mbështet Menaxherin e Mbrojtjes në lidhje me konceptin e mbrojtjes. Testimi i mbrojtjes rele dhe automatikës në nënstacionet e Transmisionit, dhe në bazë të kontratës edhe në pjesë të nënstacioneve të Distribucionit.

Detyrat specifike:

Inxhinieri i Mbrojtjes është i përfshirë në operimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e Sistemeve Mbrojtëse. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë që të:

- Ndihmon Menaxherin e Mbrojtjes në kryerjen e analizave të selektivitetit.

- Rregullisht monitoron sistemin e mbrojtjes dhe merr masa të menjëhershme në rast të devijimit të performancës.
- Mbështet Menaxherin e Mbrojtjes në mirëmbajtjen e shënimeve për performancën e rrjetit të transmissioinit dhe incidenteve.
- Ndhmon Menaxherin e Mbrojtjes në përgatitjen dhe monitorimin e metrikës së kualitetit të energjisë
- Ndhmon Menaxherin e Mbrojtjes që të siguroj që të vendosën aranzhime efikase për bashkërendimin operativ me Operatorin e Sistemit, përdoruesit e sistemit, dhe pjesëmarrësit e tregut.
- Siguroj që të vendosen aranzhime efikase për bashkërendimin operativ me Operatorët e Transmissioinit në vendet fqinje.
- Azhurnimi i test protokolleve të pajisjeve kontrolluese dhe i vizatimeve.
- Mirëmban bashkëpunim të ngushtë me planifikuesit e Selektivitetit të Mbrojtjes dhe me funksionet e kohës reale të Operimit të Rrjetit.
- Gjatë intervenimeve dhe riparimeve bënë përdorimin e drejtë të veglave dhe pajisjeve të punës, si dhe përkujdeset për procedurat e sigurisë në punë.
- Në koordinim me dispeçeret kryesor hap dhe mbyll urdhëresat e punës.
- Intervenimet për prishjet në sistem elektroenergjetik në çdo kohë, nxjerrja e të dhënave për prishjen nga mbrojtjet rele në mënyre që sistemi të rikthehet në punë në kohën sa më të shkurtë të mundshme
- Realizon në teren ndërrimet periodike të mbrojtjeve rele të mbingarkesës në Linjat e Interkonjeksionit me vendet Fqinje.
- Realizon në teren ndërrimet periodike të mbrojtjeve rele të mbingarkesës në Linjat interne.
- Kalkulon dhe realizon në teren ndërrimin e parametrave të përkohshëm të mbrojtjeve rele në sistem për shkak të ndërrimit të konfiguracionit të përkohshëm të rrjetit Transmetues si shkak i realizimit të projekteve.
- Kalkulon dhe realizon në teren ndërrimin e parametrave të mbrojtjeve rele në sistem për shkak të ndërrimit të konfiguracionit të rrjetit Transmetues (shtimi dhe këputja e linjave dhe Transformatorëve të ri) si shkak i realizimit të projekteve.
- Merr pjesë në shqyrtimin dhe korrektimin e planeve, dizajneve dhe aprovimin e tyre në kuadër të zhvillimit të projekteve.
- Merr pjesë në komisionim dhe përcjelljen e projekteve që zhvillohen në kuadër të zhvillimit të rrjetës elektroenergjetike të KOSTT-it, si dhe testimet e pajisjeve në kuadër të pranimit teknik (në Fabrikë-FAT) apo në kuadër të lëshimit në punë në teren.

Të tjera

Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri i Mbrojtjes dhe të cilat kërkohen për funksionimin efektiv të KOSTT-it.

Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera të Inxhinierit për testim, mirëmbajtje dhe akordim të releve:
Kandidatët/et përveç kushteve të përgjithshme të punësimit të cilat kërkohen me ligj, duhet ti plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
- Përvojë Pune profesionale 2 vite
- Njohje të thellë të industrisë së shërbimeve publike në nivel lokal dhe global
- Përvojë në kompanitë e transmissioinit dhe/ose operimin e sistemit
- Përvojë në sistemet mbrojtëse
- Njohja e gjuhës angleze

Kushtet e punës: Puna në Zyre dhe teren

Vendi/Lokacioni: Selia Qendrore e KOSTT-it

Forma e aplikimit për të gjitha pozitat e shpallura:

Të interesuarit mund të aplikojnë përmes formës elektronike duke i plotësuar aplikacionet të cilat mund t'i shkarkojnë nga Web Faqja e KOSTT-it: www.kostt.com

E-mail adresa ku duhet të aplikohet është: punesimi@kostt.com

Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët, të cilët i plotësojnë kërkesat e parashtruara si në konkursin publik të shpallur në mjetet e shkruara të informimit dhe në webfaqen zyrtare të KOSTT-it.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e diplomës së shkollimit si dhe kopjet e dëshmive tjera sipas kërkesave të konkursit.

Dokumentet origjinale të cilat i vërtetojnë faktet e theksuara në aplikacion duhet të prezantohen në momentin e intervistimit ose para intervistimit nëse kërkohen.

Selektimi i kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit, testimi me shkrim, intervista, përzgjedhja dhe informimi i kandidatëve do të bëhen në përputhje me afatet dhe kriteret sipas udhëzimit administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nr.07/2017.

Konkursi publik mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e shkruara të informimit dhe në webfaqen e KOSTT, nga data 24.08.2023 deri me datën 07.09.2023 ora 24:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen. KOSTT ofron mundësi të barabarta të punësimit për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe të rinjtë që të aplikojnë për këto vende pune.